



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:114012  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05869832

CAP.nr.1703//2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hidajete Gashi Alaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit të përmbartimit E.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.K, avokat nga Prishtina, ndaj debitorit të përmbartimit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, në Prishtinë me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.600/2023 të datës 27.09.2023, me datë 27.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.600/2023 i datës 27.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.600/2023 të datës 27.09.2023, ka vendosur si në vijim:

*“I. REFUZOHET, prapësimi i debitorit të përmbartimit SHSKUK me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.600/23, të dt.20.06.2023 mbi caktimin e përmbartimit, si i pabazuar.*

*II.OBLIGOHET, debitori i përmbartimit SHSKUK në Prishtinë, që të autorizuarit kreditorit të përmbartimit t’ia kompensoi shumën prej 156.00€, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim.”*

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, debitori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi Cpc.nr.600/2023 të datës 27.09.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të anulohet si i pa bazë, i pasafatshëm dhe i palejueshëm, pasi që bazuar në nenin 391 të LPK-së kemi të bëjmë me çështje që është gjykuar (res judicata).

Kreditori përmes të autorizuarit ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit, me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi Cpc.nr.600/2023 i datës 27.09.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datën 18.05.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaremit në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, Vendimit nr.303/2020 të datës 19.05.2020 si dhe Vendimit për korigjimin e gabimeve të IP-së të shkallës së I-rë Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, me gjerësisht si në propozimin për përmbaremit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremit të kreditorit, me aktvendimin Cpc.nr.600/2023, të datës 20.06.2023, e ka caktuar përmbaremitin.

Kundër aktvendimit mbi caktimin e përmbaremit, brenda afatit ligjor, debitori ka ushtruar prapësim, në prapësimin e ushtruar, debitori ka theksuar se për të njëjtën çështje përfaqësuesi i kreditorit ka paraqitur propozim për përmbaremit P.nr.1135/2020 të datës 28.05.2020 ndaj debitorit QKUK, në bazë të vendimit të njëjtë të Inspektoratit të punës 01Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020 dhe si rrjedhojë Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin PPP.nr.1660/20 të datës 18.01.2021 e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbaremit. Po ashtu, Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë për këtë çështje me Aktvendimin Ac.nr.9031/21, të datës 26.04.2022 e ka refuzuar ankesën e kreditorit. Me tej ka theksuar se, propozimi për përmbaremit i kreditorit është i pasafatshëm, kjo sipas pikës V të Mendimit Juridik të gjykatës Supreme të Kosovës, sepse ky propozim është bërë pas afatit të zbatueshmërisë së Kontratës kolektive Sektoriale, dhe për më tepër në këtë rastin konkret kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res judicata).

Kreditori përmes të autorizuarit ka paraqitur përgjigje në prapësim me arsyetimin se, pretendimet e debitorit në prapësim se propozimi për përmbaremit i mbështetur në Kontratën Kolektive të Shëndetësisë është i pasafatshëm dhe pretendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, pretendimet e tilla i ka konsideruar si të pa bazuara pasi që vendimet në bazë të cilave është bërë propozimi për përmbaremit janë vendosur para 2 vite, dhe nuk kemi të bëjmë me

propozim të pasafatshëm, ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim dhe të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, të vërtetohet aktvendimi përmbarimor Cpc.nr.600/2023, të datës 20.06.2023, si dhe të obligohet debitori i përmbarimit të paguaj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim sipas TOAK-së.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.600/2023, të datës 27.09.2023, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, pas shqyrtimit të prapësimin, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i përmbarimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Me tutje ka shtuar se, me nenin 24 par.3 të LPP-së është rregulluar se: Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë, ndërsa me par.5 të njëjtit nen është rregulluar se: Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin.

Në rastin konkret pretendimet e debitorit të përmbarimit se, propozimit për përmbarim i kreditori është i pasafatshëm, gjykata vërejtë se dokumenti përmbarues në bazë të cilit është caktuar përmbarimi është nxjerrë në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale.

Ndërsa pretendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata), dhe se me të njëjtin vendim gjykata e ka aprovuar prapësimin dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim, një pretendim i tillë për gjykatën është i pa bazuar ngase propozimi për përmbarim është bërë në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën debitori obligohet t'ia paguaj kreditorit, rrjedhimisht me këtë dokument përmbarues është bërë vetën në këtë rast propozimi për përmbarim, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar.

Si në pikën dy të dispozitivit gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 463 par. 1 dhe 2.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e ka refuzuar si të tillë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita

konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) m) si dhe pikën d) të LPK-së, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, dhe se propozimi për përmbartim është i pasafatshëm sepse ky propozim është bërë pas afatit të zbatueshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, i palejueshëm ngase kemi të bëjmë me një çështje të gjykuar, pretendimet e tilla i ka konsideruar si të pa bazuara pasi që vendimet në bazë të cilave është propozimi për përmbartim janë vendosur para 2 viteve, dhe nuk kemi të bëjmë me propozim të pasafatshëm. Tutje ka shtuar se, debitori lidhur me obligimin ndaj kreditorit nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që e ka përmbushur obligimin, dhe asnjë provë lidhur me pretendimet e cekura në prapësim ashtu siç kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP-së, mirëpo prapësimi është paraqitur vetëm sa për të zvarritur procedurën.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim ngase është në përputhje me nenin 27 të LPP, ku në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor-Vendimi për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, në dispozitiv të tij i përmban të gjitha kushtet nga neni 27 i LPP-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që aktvendimi i atakuar është i ekzaminueshëm, ka një dispozitiv të qartë dhe në përputhje me arsyetimin, ka një rrjedhë logjike në mes të dispozitivit dhe arsyetimit, në arsyetim janë dhënë arsye për faktet vendimtare, vlerësimin e provave mbi bazën e të cilave është vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Sa i përket pretendimeve në prapësim dhe ankesë lidhur me paafatshmërinë, gjykata gjenë se një pretendim i tillë është pretendim i pa arsyetuar, sepse pala debitore nuk ka dhënë arsye për çfarë afati ka pretenduar, sepse theksimi i afatit të validitetit të Kontratës Kolektive nuk ka asnjë lidhje logjike e as juridike me afatin për paraqitjen e propozimit për përmbartim. Afatshmëria për paraqitjen e propozimit ka të bëjë në raport me vendimin gjyqësor apo administrativ dhe jo në raport me kohën e validitetit të kontratës pasi atë prapësim të afatit pala debitore ka qenë dashur që ta shfrytëzojë në procedurë administrative aty ku shqyrtohet ligjshmëria e vendimit dhe jo në procedurë përmbartimore e cila është procedurë që udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal juridik.

Ndërsa lidhur me atë se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i palejuar pasi që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, kjo nuk qëndron, ngase edhe sipas Gjykatës së Apelit propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të vendimit të inspektoriatit të punës për krigrimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën debitori obligohet t'ia paguaj kreditorit, rrjedhimisht me këtë dokument përmbarrues është bërë vetëm propozimi për përmbarrim, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se nuk qendrojnë pretendimet e prapësimi të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbarrueshmërisë së dokumentit përmbarrimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, si dhe lidhur me paaftshmërinë dhe palejueshmërinë e propozimit për përmbarrim, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit. Në raport me plotësimin e kushteve për tu vlerësuar një çështje se a është çështje e gjykuar apo jo duhet së pari në raport me atë çështje të vendoset në meritë dhe jo në aspekt procedural, si dhe kushtete tjera siç janë: njëjtësia e objektit, palëve dhe bazës juridike.

Po ashtu, pretendimet ankimore të debitorit se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që propozimi për përmbarrim është paraqitur nën 21,24,27 dhe nën 36 të LPP-së, dhe në kundërshtim me nën 50 të Ligjit të Procedurës Administrative (LPA-së) dhe nën 162 par 2 dhe par 3 dhe nën 391 pika d) të LPK-së, ky pretendim nuk qëndron ngase me nën 24 par 3 të LPP-së përcaktohet se “Vendimi i dhënë në procedurë administrative, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedurë e tillë” kurse me par 5 të të njëjtit nën përcaktohet se “Përmbarrimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative, që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin”.

Andaj, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nën 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nën 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1703//2023, me datë 27.06.2024

Numri i lëndës: 2023:114012  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05869832

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.